

AKT – THEMELIMI
I
SHOQËRISË AKSIONERE ME OFERTE PRIVATE
EMK PETROL

NENI 1
THEMELUESIT E SHOQËRISË

Gjergj Lekaj, atësia Lek, amësia Age, shtetas Shqiptar, lindur në Ishull-Lezhë, Lezhë dhe banues në adresën Gjonpalaj 03140032; Nd. 8/3; H. 1; Shëngjin; Ishull-Lezhë; 4503; Lezhë, i datëlindjes 04/04/1963, me dokument identifikimi Leternjoftim ID nr. 037657252 dhe nr. personal G30404073W.

Sot me datën 01.10.2024 kanë vendosur të themelojë Shoqerine Aksionere **EMK Petrol** në përputhje me ligjin 9901 date 14.04.2008” Për Tregtaret dhe shoqeritë Tregtare” duke firmosur këtë akt themelimi.

NENI 2
EMËRTIMI, FORMA DHE SELIA E SHOQËRISË.

Emri i shoqerise aksionere do të jetë **EMK Petrol**

Forma e shoqërisë do të jetë Shoqëri Aksionere me Oferte Private.

Adresa e saj zyrtare është Shoqëria **EMK Petrol** Lezhë, Njësia Administrative Shëngjin, Ishull-Lezhë, lagjia Gjergj Simoni” Rruga Kryesore Zona kadastrale 1986, pasuria nr.206/1.

Shoqëria do të ushtroje aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Ajo mund të krijojë dhe të mbyllë në Shqipëri ose jashtë saj filiale, përfaqësi apo seli të tjera.


NENI 3
KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë është pa limit. Si datë e fillimit të aktivitetit të saj do të jetë data e regjistrimit të saj në QKB.

NENI 4
OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Objekt i veprimtarisë ekonomike të shoqërisë aksionere është:

- Blerjen, importimin, shitjen me shumicë të naftës, gazit, bitumit, solarit, vajrave lubrifikante, biokarbureve dhe karburantit të avionëve.
- Blerjen, importimin, transportimin për llogari të vetë dhe të tretëve, depozitimin, përzierjen, trajtimin, shitjen, shpërndarjen me shumicë të gazit, lubrifikanteve, produkteve e nënprodukteve të naftës dhe naftokimike.
- Blerjen, shitjen, qeradhënien, ndërtimin dhe administrimin e impianteve, depozitave dhe administrimin e ndërtesave dhe pasurive të veta të paluajtshme.
- Gjithashtu shoqëria do të mund të kryejë të gjitha ato veprime që organet drejtuese të saj i konsiderojnë të nevojshme, ose të dobishme për arritjen e qëllimit të shoqërisë, përfshi këtu edhe lëshimin e dorezanive dhe të garancive të tjera.



NENI 5 KAPITALI THEMELOR

Kapitali themelor i shoqërisë Aksionere **EMK Petrol** do të jetë 3,500,000 lekë i ndarë në 1 aksion.

Themeluesi aksioner i shoqërisë ka të drejtë ta zvogëlojë ose ta zmadhojë kapitalin e shoqërisë në natyrë dhe në para, në përputhje me statutin e shoqërisë. Në këtë rast do të bëhen veprimet përkatëse për pjesëmarrjen e aksionerëve në kapitalin themeltar.

Kapitali themeltar i Shoqërisë i ndarë në aksione në para është nënshkruar nga aksioneri themelues si me poshte:

Nr	Emri mbiemri	Kontributi ne %	Numri i aksioneve	Kontributi ne para	
1	Gjergj Lekaj	100%	1	3,500,000	

Kapitali do të jetë kontribut në para dhe është i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm. Themeluesi aksioner ka të drejtë ta zmadhojë dhe ta zvogëlojë kapitalin e shoqërisë në natyrë dhe në para në përputhje me statutin e shoqërisë.

Shoqëria nuk është përgjegjëse për detyrimet e aksionerëve jashtë shoqërisë. Aksioneri përballon humbjen vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

NENI 6 ORGANET E SHOQËRISË

Shoqëria drejtohet organizohet dhe administrohet nga organet e saj që janë Asambleja e Përgjithshme dhe Këshilli Mbikqyrës me një administrator **.(shoqëri me dy nivele administrimi)**

NENI 7 ASAMBLEJA E PËRGJITSHME


Asambleja e përgjithshme është organi vendimor i shoqërisë Aksionare dhe merr vendimet më të rëndësishme për ecurinë e shoqërisë. Asambleja e përgjithshme përbëhet nga aksionerët e shoqërisë.

NENI 8 KËSHILLI MBIKQYRES

Organi mbikqyrës i Shoqërisë është Këshilli Mbikqyrës . Statuti i shoqërisë përcakton kompetencat e Këshillit Mbikqyrës. Në përputhje me nenin 154 të ligjit 9901 date 14.04.12008 për 3-vitet e para, anëtarët e këshillit mbikqyrës janë ata të përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

NENI 9 ADMINISTRATORI

Shoqëria do të administrohet dhe përfaqësohet nga një Administrator i cili do të përbëhet nga një anëtar që do të emërohet nga asambleja e përgjithshme për një periudhë 3-vjeçare. Statuti i shoqërisë përcakton kompetencat e Administratorit.



NENI 10
VITI FINANCIAR

Viti i pare financiar do te filloje me rregjistrimin e shoqërisë në Rregjistrin Tregëtar të QKB dhe do të mbarojë me 31.12.2024.

NENI 11
MOSMARRËVESHJET

Për çdo mosmarrëveshje e lindur në kuadrin ose për shkak të kësaj kontrate çështja i paraqitet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, duke gjykuar mbi bazën e ligjeve shqipëtare.

NENI 12
PRISHJA E SHOQËRISË

Shoqëria aksionere prishet kur:

- a- Kur mbaron kohëzgjatja për të cilën është themeluar.
- b- Me vendim të asamblesë së përgjithshme.
- c- Me hapjen e procedurave të falimentimit
- d- Nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit 9723 datë 03.05.2007 “ Per QKR”
- dh- Me vendim Gjykate
- e- Për arsye të tjera të parashikuara në statut.

NENI 13
DISPOZITA TË FUNDIT

Të gjitha shpenzimet që do të kryhen deri në rregjistrimin e shoqërisë si person juridik do të përfshihen në bilancin ekonomik të shoqërisë.

Ky Akt-Themelimi përbëhet nga 12 nene. Ai është i përgatitur në 4 kopje në gjuhën shqipe.

Ky Akt-Themelimi u shkrua, u lexua dhe u firmos me vullnet të lirë e të plotë nga Aksioneret themelues i Shoqërisë, para noterit në Lezhë sot me datë 01.10.2024

AKSIONERI THEMELUES

GJERGJ ZEKAJ
